



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

Nr. 1219 Prot.

Tiranë, më 08.07.2022

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, dhe Vendimit Nr. 364, datë 29.5.2019 të Këshillit të Ministrave “Për Funksionimin dhe Mënyrën e Zhvillimit të Veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, Urdhërit të Kryeministrit, nr. 137, datë 21.10.2019, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore” të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore shpall konkursin për pozicionin:

SPECIALIST NË SEKTORIN E QENDRAVE HISTORIKE, ARKITEKTURA E TRADITËS DHE PEIZAZHIT,
kategoria e pages IV-a

1. KUSHTET PËR KONKURIM DHE KRITERET E VEÇANTA:

1.1 Kandidati duhet të plotësojë kushtet për konkurim si vijon:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- f) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- g) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shtuar sipas këtij ligji.

1.2 Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Duhet të ketë arsimin e lartë me diplomë të Nivelit të Dytë të njohur nga Ministria e Arsimit të Shqipërisë, në degët Inxhinieri Ndërtimi / Arkitekturë / Planifikim Urban. Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" apo "Master Profesional" të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë në Inxhinieri ndërtimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

/Arkitekturë/Planifikim Urban. Diploma e nivelit Bachelor, duhet të jetë e të njëjtës fushë;

- b) Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet në fushën përkatëse të diplomimit.
- c) Preferohet të jetë i specializuar në fushën e restaurimit ose studimit të trashëgimisë kulturore (studime pas universitare/kurse/trajnime të shoqëruara me certifikatë ose diplomë përkatëse), si dhe me eksperiencë pune në fushën profesionale.
- d) Të ketë aftësi për tu përshtatur me kushtet, teknologjinë dhe procedurat e reja të standarteve evropiane.
- e) Të njohë dhe zbatojë kodin e punës, kodin e procedurës administrative.
- f) Të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të BE.
- g) Të ketë aftësi praktike të të punuarit në kompjuter, në rrjet / sistem, Internet, programe dhe softe: Autocad, Adobe, Photoshop, Paketa Microsoft Windoës (Word, Exel, Power Point, etj), etj. Njohja e programeve të tjera kompjuterike përbën avantazh.
- h) Të ketë aftësi të mira për: përshtatje pune në grup; të ketë aftësi të përmbushë detyrat brenda afateve të përcaktuara; aftësi komunikimi, referimi dhe mbrojtje të të dhënave, analizave, vendimeve, monitorimit dhe raportimit.

2. PËRSHKRIM PUNE “SPECIALIST NË SEKTORIN E QENDRAVE HISTORIKE, ARKITEKTURA E TRADITËS DHE PEISAZHIT”- DMK:

- 1. Kryen studime kërkimore në lidhje me pasuritë e trashëgimisë kulturore të paluajtshme sipas fushës së kompetencës por edhe në bashkëpunim me sektorët e tjerë teknikë të IKTK-së.
- 2. Duke u mbështetur në studime shkencore dhe problematikën e objekteve në terren, harton projekte për punimet konservuese, restauruese, rijetëzuese që do të kryhen në pasuritë e trashëgimisë kulturore sipas fushës së kompetencës.
- 3. Harton detyra projektimi dhe terma reference për plane menaxhimi, studime, projekte konservim, restaurim dhe rijetëzimi të pasurive kulturore, zbatimi të punimeve restauruese, etj.
- 4. Kryen periodikisht vizita në terren për gjurmimin, kontrollin e gjendjes së konservimit, hulumtimin e objekteve me interes kulturor si dhe hartimin e dokumentacionit tekniko-administrativ të tyre.
- 5. Harton dokumentacionin e nevojshëm në kuadër të propozimeve për përfshirje në Listën e Pasurive Botërore sipas fushës së kompetencës.
- 6. Shqyrton aplikimet online për projektet e mirëmbajtjes, restaurimit, konservimit, rijetëzimit në pasuritë e trashëgimisë kulturore të paluajtshme sipas fushës së kompetencës dhe i sugjeron Titullarit të institucionit dhe Këshillit Teknik miratimin ose jo të tyre.
- 7. Me urdhër të titullarit të institucionit mbikëqyr dhe kolaudon në mënyrë periodike zbatimin e punimeve të drejtpërdrejta restauruese në pasuritë e trashëgimisë kulturore materiale të paluajtshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

8. Me urdhër të titullarit të institucionit, asiston me konsulencë teknike apo administrative sipas fushës së kompetencës me palët e treta, institucione publike apo private me të cilat IKTK-ja ka marrëveshje bashkëpunimi.
9. Kontribuon me artikuj shkencorë në revistën “Monumentet”.

3. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT:

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë;

- a) Jetëshkrim i aplikantit;
- b) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- c) Fotokopje të noterizuar diplomës;
- d) Fotokopje të noterizuar të listës së notave;
- e) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- f) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- h) Çertifikata kualifikimi;
- i) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në protokollin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, brenda datës 18.07. 2022.

4. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK:

Brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit të aplikimit në datën **22.07. 2022**, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve që plotësojnë kushtet për konkurim, dhe do të shpallë në faqen e internetit të saj, listën e kandidatëve të kualifikuar që vazhdojnë konkurimin, datën, orën dhe vendin ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk janë shpallur të kualifikuar, do të njoftohen me e-mail nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe kanë të drejtë të paraqiten prane tij për t'u njohur me arsyet e moskualifikimit.

Ata mund të ankohen brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e listës. Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, do të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 2 (dy) ditëve pune.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

**5. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO
TË ZHVILLOHET INTERVISTA:**

Kandidatët e kualifikuar për vazhdimin e konkurimit, do të vlerësohen për:

- Njohuritë mbi:

- a) Ligji nr.76/2016, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- b) Ligjin Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” dhe aktet ligjore dhe nënligjore të tij;
- c) Vendimin Nr. 364, datë 29.5.2019 të Këshillit të Ministrave “Për Funksionimin dhe Mënyrën e Zhvillimit të Veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”;
- d) Kodin e Procedurave Administrative;
- e) Legjislacionin mbi konfliktin e interesit dhe parandalimin e tij;
- f) Legjislacionin për Kodin e Punës dhe rregullat e etikës në administratën publike.

**6. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E
KOMUNIKIMIT:**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore do ti njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) dhe do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në këndin e njoftimeve të publikuara pranë Institucionit.

Për sqarime të mëtejshme mund të kontaktoni në numrin e telefonit: +355 69 38 93 549, ose në adresën: Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore: “Rr. “Aleksander Moisiu” nr.76, Ish-Kinostudio, Tiranë, SHQIPËRI”.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

RUDINA ZOTO

